



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 168

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “DREJTËSIA SHOQËRORE”, ME KRYETAR Z. TANUSH KASO, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot, më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1206 prot., datë 21.2.2025, me:

- KËRKUES:** Partia politike Partia “Drejtësia Shoqërore”, me kryetar Z. Tanush Kaso
OBJEKTI: Regjistrimi i partisë politike Partia “Drejtësia Shoqërore” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
BAZA LIGJORE: Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Drejtësia Shoqërore” nëpërmjet Kryetarit, Z. Tanush Kaso, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 25.2.2025 Nr: 168
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Drejtësia Shoqërore”, me Kryetar Z. Tanush Kaso, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 20.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Drejtësia Shoqërore”, me iniciale “PDSHSH”, me Kryetar Z. Tanush Kaso, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Drejtësia Shoqërore” me shkronja nistore “PDSHSH”, me adresë: Rruga "Viktor Eftimiu", Nd. 18, H. 3, Ap. 3, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Tanush Kaso, me adresë: Rruga "Viktor Eftimiu", Nd. 18, H. 3, Ap. 3, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Ermira Kaso, me adresë: Rruga "Viktor Eftimiu", Nd. 18, H. 3, Ap. 3, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Tanush Kaso, me adresë: Rruga "Viktor Eftimiu", Nd. 18, H. 3, Ap. 3, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Drejtësia Shoqërore”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Drejtësia Shoqërore” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”.



V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Drejtësia Shoqërore”, me kryetar Z. Tanush Kaso, me shkronjat nistore “PDSHSH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI